



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 135, Datë 11.04.2023

MBI

**MIRATIMIN E AMENDIMIT NR. 2 TË KONTRATËS “PËR SHITBLERJEN E  
ENERGJISË ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË SISTEMIN E  
TRANSMETIMIT NDËRMJET OST SH.A. DHE KESH SH.A.”**

Në zbatim të neneve 16, 20 gërma “h”, 47, 56 gërma “f”, 62 dhe 90 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; Pjesës I, nenit 4, pikës 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.06.2022 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; VKM-së nr. 650, datë 10.10.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 584, datë 08.10.2021 “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”; VKM-së nr. 519, datë 13.07.2016 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, i ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.04.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1111/1 prot., datë 07.04.2023, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike “Mbi amendimin nr.2 të kontratës për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a.”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 30, datë 16.02.2023 miratoi amendimin nr. 1 të Kontratës “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit” ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. dhe Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) sh.a., miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 230, datë 12.09.2022.
- Palët, nëpërmjet shkresës së përbashkët nr. 1691/1 prot., të OST sh.a. dhe nr. 1668/1 prot., të KESH sh.a., datë 23.03.2023, protokolluar në ERE me nr. 1111 prot., datë 23.03.2023, kanë përcjellë amendimin nr. 2 të Kontratës “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit” ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a, i cili gjendet gjithashtu i publikuar në faqen zyrtare të internetit të ERE, në rubrikën “Konsultime”.

- Nga shqyrtimi i kontratës të miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 230/2022 dhe Amendimit nr. 2 të kësaj kontrate vihen re këto ndryshime:
  - **Neni 1 i Amendimit nr. 2 të kontratës të paraqitur për miratim**, amendon Nenin 3 (Të drejtat dhe detyrimet e blerësit) të kontratës të miratuar me vendimin nr. 230, datë 12.09.2022, (ndryshuar me vendimin e bordit të ERE nr. 30, datë 16.02.2023).
  - **Neni 2 i Amendimit nr. 2 të kontratës të paraqitur për miratim**, amendon Nenin 7 (Dorëzimi, Matja, Transmetimi dhe Risku) të kontratës të miratuar me vendimin nr. 230, datë 12.09.2022, (ndryshuar me vendimin e bordit të ERE nr. 30, datë 16.02.2023).
  - **Neni 3 i Amendimit nr. 2 të kontratës të paraqitur për miratim**, amendon Nenin 11 (Faturimi dhe pagesa) të kontratës të miratuar me vendimin nr. 230, datë 12.09.2022, (ndryshuar me vendimin e bordit të ERE nr. 30, datë 16.02.2023).
- Rezulton një gabim material në numërim në Amendimin nr. 2 të kontratës të paraqitur për miratim, pasi përsëritet dy herë në numërim Neni 3, Neni 3 i përsëritur (i cili duhet të ndryshohet sipas numërimit në Neni 4) i Amendimit nr. 2 të kontratës të paraqitur për miratim si dhe Nenet 4 dhe 5 duhet të ndryshohen përkatësisht në Nenet 5 dhe 6.
- Duke marrë në konsideratë procesin e operimit të bursës ALPEX, amendimet e paraqitura nga palët, vlerësohet se do të mundësojnë që kjo Kontratë të trajtohet si Kontratë OTC (Over the Counter Contracts) në DAM që do të zhvillojë ALPEX, ku i jepet përparësi përputhjes së Urdhër Porosive të blerësit dhe shitësit. Si blerësi ashtu edhe shitësi do të krijojnë një portofol të dedikuar për zbatimin e detyrimeve të kontratës OTC në ALPEX DAM për të përmbushur vëllimet sipas kësaj Kontrate.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Miratimin e Amendimit nr. 2 të Kontratës “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a. (Amendimi bashkëlidhur këtij vendimi).
2. Amendimi nr. 2 i kontratës së nënshkruar nga palët “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a.” me korrigjimet përkatëse të dërgohen në ERE brenda 5 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

3. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqëritë OST sh.a. dhe KESH sh.a. për vendimin e bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**



Nr. 1691 prot. Tiranë, më 23.03.2023

Nr. 1668 prot. Tiranë, më 23.03.2023

**AMENDIMI NR.2**

**I**

**KONTRATËS**

**PËR**

**SHITBLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE  
NË SISTEMIN E TRANSMETIMIT**

**ndërmjet**

**OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT**

**OST SHA**

**DHE**

**KESH SHA**

Sot në datë \_\_. \_\_. 2023, duke u mbështetur në vullnetin e lirë të:

- (1) **Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare, KESH SHA.**, shoqëri aksionare, regjistruar si person juridik me Vendimin Nr.12728, datë 06.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në: Bllokun “Vasil Shanto”, Tiranë, Shqipëri, me nr. NIPT-i J61817005F, e përfaqësuar nga Z. Ergys Verdho, Administrator i Shoqërisë KESH SHA., që më poshtë do të quhet “Shitësi”,

dhe

- (2) **Operatori i Sistemit të Transmetimit**, (më poshtë referuar si OST SHA.), shoqëri aksionare, regjistruar si person juridik me Vendimin Nr. 31935, dt. 14.07.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me adresë: Tiranë Kashar, Yrshek, autostrada Tiranë-Durrës, km 9, Tiranë, Shqipëri, me NIPT Nr. K42101801N, përfaqësuar nga **Z.Skerdi Drenova, Administratori i OST SHA.**,

#### **Baza ligjore:**

- a) Ligji Nr. 43/2015, datë 30.04.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar;
- b) VKM Nr. 456, datë 29.6.2022 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”;
- c) VKM Nr. 584 datë 08.10.2021 “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike” (i ndryshuar);
- d) VKM Nr. 519, datë 13.7.2016 “Për Miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike” (i ndryshuar)
- e) Vendim i ERE Nr. 347, datë 27.12.2022 “Mbi për Miratimin e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike (Rregullat e Alpex Përkufizimet, Procedura e Tregtimit si dhe Procedura e Klerimit dhe Shlyerjes)”
- f) Kodi i Transmetimit, miratuar me Vendimin e ERE Nr. 63 dt.11.04.2022;
- g) Vendimi i ERE Nr. 99, datë 17.06.2016, “Mbi miratimin e Licensës së Prodhimit të Energjisë Elektrike”;
- h) Vendimi i ERE Nr. 134, dt. 06/09/2017 “Mbi liçensimin e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit OST-sh.a. në aktivitetin e operimit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”;
- i) Vendimi i ERE Nr. 253, datë 21.12.2021 “Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2022”
- j) Kontrata “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në Sistemin e Transmetimit” nr.4670/1 prot., të OST SHA, datë 27.07.2022 dhe nr.3635/2 prot., të KESH SHA (e amenduar)

**Ndërsa**, midis OST SHA. dhe KESH SHA është lidhur Kontrata “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në Sistemin e Transmetimit” nr.4670/1 prot., të OST SHA, datë 27.07.2022 dhe nr.3635/2 prot., të KESH SHA; e cila është miratuar nga ERE me Vendimin nr. 230, datë 12.09.2022 dhe është amenduar dhe miratuar nga ERE me Vendimin nr. 30, datë 16.02.2023 “Mbi miratimin e Amendimit nr. 1 të Kontratës për Shitblerjen e

Energjisë Elektrike për Mbulimin e Humbjeve në Sistemin e Transmetimit ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit OST SH.A. dhe KESH SH.A.”;

**Ndërsa**, VKM Nr. 519, datë 13.7.2016 “Për Miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike” (i ndryshuar), në pikën 8 “Zbatimi i modelit të tregut” parashikon se: “Modeli i tregut të organizuar, siç është përcaktuar në këtë tekst, do të jetë i aplikueshëm në momentin e fillimit të punës së Bursës Shqiptare të Energjisë”.

**Ndërsa**, VKM Nr. 519, datë 13.7.2016 “Për Miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike” (i ndryshuar), në pikën 3.1, paragrafi 2, nënparagrafi 3 parashikon se: “OST-ja kryen funksionin e Operatorit të Tregut Balancues, nëpërmjet: - blerjes së humbjeve në transmetim, në tregun e organizuar të ditës në avancë.”.

**Si dhe**, Kontrata “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në Sistemin e Transmetimit” nr. 4670/1 prot., të OST SHA, datë 27.07.2022 dhe nr. 3635/2 prot., të KESH SHA, datë 03.08.2022, neni 17 “Të ndryshme”, pika 2 parashikon se: “Çdo amendim ose shtesë në këtë Kontratë do të bëhet vetëm me shkrim dhe do të nënshkruhet nga të dyja Palët”; dhe neni 18 “Miratimi i ERE-s, hyrja në fuqi, efektet dhe zgjidhja e parakohshme”, pika 2 parashikon se: “Kjo kontratë mund të ndryshohet apo zgjidhet përpara datës së përfundimit të saj, vetëm me miratimin e ERE”.

Palët bien dakord lidhur me përmbajtjen e Amendimit Nr. 2 të Kontratës “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në Sistemin e Transmetimit” nr. 4670/1 prot., të OST SHA, datë 27.07.2022 dhe nr. 3635/2 prot., të KESH SHA, datë 03.08.2022, si më poshtë vijon:

### **Neni 1**

Neni 3 “Të drejtat dhe detyrimet e blerësit” e kontratës “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në Sistemin e Transmetimit” nr.4670/1 prot., të OST SHA, datë 27.07.2022 dhe nr.3635/2 prot., të KESH SHA, datë 03.08.2022 (e amenduar), ndryshon si më poshtë vijon:

Para hapjes së portës së ofertimit në DAM/ALPEX, Blerësi dhe Shitësi do të rakordojnë me njëri-tjetrin programin ditor të energjisë me bazë orare të parashikuar për nevojat e mbulimit të humbjeve në rrjetin e transmetimit, në përputhje me dispozitat e akteve ligjore, nënligjore dhe rregullatore në Sektorin e Energjisë Elektrike dhe parashikimeve të kësaj kontrate.

### **Neni 2**

Neni 7 “Dorëzimi, Matja, Transmetimi dhe Risku” i kontratës “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në Sistemin e Transmetimit” nr.4670/1 prot., të OST SHA, datë 27.07.2022 dhe nr.3635/2 prot., të KESH SHA, datë 03.08.2022 (e amenduar), ndryshon si më poshtë vijon:

1. Titulli i nenit bëhet “Dorëzimi, Transmetimi dhe Kompensimi”
2. Shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

**4. Rimbursimi i kontratës OTC:** Në rast se KESH sh.a. nuk shpallet fitues nga ALPEX për lëvrim energjie elektrike të rakorduar mes palëve për dayahead, atëherë KESH sh.a. duhet të rimbursojë financiarisht OST sh.a. për sasinë e energjisë elektrike të blerë nga ALPEX me diferencën e çmimit të nxjerrë për atë orë nga ALPEX me çmimin e kësaj kontrate.

### Neni 3

Neni 11 “Faturimi dhe pagesa”, bëhet si më poshtë:

- 1. Fatura:** Të dyja palët pasi kanë kleruar sasinë e energjisë në ALPEX në ankandin përkatës për cdo Njësi Kohore Tregtimi për ditë të caktuara lëvrimi, do të bëjnë rregullimin nëpërmjet faturimit për diferencën midis çmimit klerues për Njësi Kohore të Tregut për këtë ditë lëvrimi me çmimin e parashikuar në kontratë. Fatura do të jete ditore, me qëllim barazimet financiare të energjisë sipas pikës 6, të këtij neni dhe do të lëshohet nga pala e cila mban të drejtën e kompensimit. Fatura do të mbështetet në raportin e hartuar nga palët sipas pikës 2, të këtij neni. Paraqitja e kësaj fature do të bëhet në ditën D për cdo proces ankandi në DAM të ditës D-1, dhe kur kjo ditë është ditë pushimi dhe ose festë zyrtare, ditën e ardhshme më të parë të punës, për secilin proces ankandi të ditës D-1.
- 2. Raporti (Aneksit 1, pjese e kësaj kontrate):** Palët do të hartojnë një raport i cili pasqyron diferencat midis çmimit të DAM/ALPEX dhe çmimit të kontraktuar për sasinë e energjisë që shitësi i ka shitur blerësit gjatë një dite, sipas parashikimeve të kësaj kontrate. Ky raport do të shërbejë për hartimin e faturës sipas pikës 1, të këtij neni
- 3. Pagesa:** Palët do të paguajnë vlerën e faturës sipas pikës 1. Pagesa do të bëhet brenda ditës së nesërme të lëshimit të faturës. Data e pagesës do të konsiderohet data kur fondet janë transferuar nga llogaria e blerësit.
- 4. Vonesa në kryerjen e pagesës:** Nëse pala nuk arrin të kryejë pagesën brenda afatit të përcaktuar në këtë Kontratë, penaliteti për dëmet e shkaktuara si pasojë e vonesës do të llogaritet në përputhje me ligjin nr.48/2014, “Për vonesat në detyrimet kontraktuale dhe tregtare”. (i ndryshuar)
- 5. Përkufizimi i Kontratës në treg:** Kjo Kontratë do të trajtohet si Kontratë OTC në DAM ALPEX, ku i jepet përparësi përputhjes së Urdhër Porosive të blerësit dhe shitësit. Si Blerësi ashtu edhe Shitësi do të krijojnë një portofol (të dedikuar për zbatimin e detyrimeve të OTC) në ALPEX DAM për të përmbushur vëllimet sipas kësaj Kontrate.
- 6. Barazimet financiare të energjisë elektrike:** ALPEX do të sigurojë shlyerjen e volumit të kontraktuar në ALPEX DAM, sipas Rregullave të Tregut. Nëse çmimi klerues për ato Njësi Kohore të Tregut në DAM është më i lartë se çmimi i kontratës, Shitësi do të kompensojë blerësin për diferencën midis çmimit klerues për ato Njësi Kohore të Tregut në DAM dhe çmimit të kontratës. Përkatësisht, nëse çmimi klerues për ato Njësi Kohore të Tregut në DAM është më i ulët se çmimi i kontratës, blerësi do të kompensojë shitësin për diferencën ndërmjet çmimit klerues për ato Njësi Kohore të Tregut në DAM dhe çmimit të kontratës.
- 7. Realizimi i Transaksioneve dhe Tregtimi:** Tregtimi i energjisë elektrike përfshin përputhjen e Urdhërporosive të blerjes dhe shitjes dhe do të bëhet sipas dispozitave të rregullave të tregut ALPEX. Volumet që do të kërkojë Blerësi në përputhje me parashikimet e kësaj kontrate për një ditë të caktuar lëvrimi dhe për cdo njësi kohore tregu, do të ofertohen në Sistemin e Tregimit të Energjisë (ETSS) në përputhje me dispozitat Rregullave të ALPEX-it dhe procedurat, nëpërmjet portofolit të tij, ndërkohë shitësi duhet që po nëpërmjet portofolit të tij (të dedikuar për zbatimin e OTC) të ofertojë për të njëjtën ditë lëvrimi dhe të njëjtat volume për çdo Njësi Kohore Tregu.

### Neni 3

Të gjithë nenet e tjera të kontratës “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në Sistemin e Transmetimit” nr.4670/1 prot., të OST SHA, datë 27.07.2022 dhe nr.3635/2 prot., të KESH SHA, datë 03.08.2022 (e amenduar), ngelen të pandryshuara.

### Neni 4

Ky Amendament Nr.2 i kontratës “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në Sistemin e Transmetimit” (e amenduar), nënshkruhet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme, 2 (dy) për secilën palë.

### Neni 5

Ky amendim hyn në fuqi pas miratimit nga ERE dhe i shtrin efektet që nga data që i korespondon datës së lëvrimit të ankandit të parë DAM të zhvilluar nga Bursa Shqiptare e Energjisë.

Për  
**KORPORATËN  
ELEKTROENERGJITIKE  
SHQIPTARE, KESH SH.A.**

**ADMINISTRATORI**

**Ergys VERDHO**



Për  
**OPERATORI I SISTEMIT TË  
TRANSMETIMIT,  
OST SH.A.**

**ADMINISTRATORI**

**Skërdi DRENOVA**





**Aneks 1**  
**Raporti**  
**Ndërmjet shoqërive:**

Per periudhen ....-...2023, KESH sh.a. ka levruar dhe OST sh.a. ka pranuar energjine elektrike per mbulimin e humbjeve ne rrjetin e transmetimit sipas raportit te meposhtem:

Data\ora	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	Totale
/ /2023																									
<b>Totale</b>																									

**Tipi I kontrates: Kontrate OTC.**

Intervali Kohor i Levrimitt	Sasia e levruar (MWh)	Cmimi (Konform parashikimeve te Kontrates OTC (Leke/MWh)	Cmimi DAM/ALPEX (Euro/MWh)	Diferenca e cmimeve per tu faturuar	Vlera Totale (Leke)
00-01					
01-02					
02-03					
03-04					
04-05					
05-06					
06-07					
07-08					
08-09					
09-10					
10-11					
11-12					
12-13					
13-14					
14-15					
15-16					
16-17					
17-18					
18-19					
19-20					
20-21					
21-22					
22-23					
23-24					
<b>TOTAL</b>					

*Kursi i Euro do te merret kursi i dites se prerjes se fatures*

**Konfirmuar nga KESH:**

(emer, mbiemer, firme)

**Konfirmuar nga OST:**

(emer, mbiemer, firme)

